



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
SHËRBIMI I PROVËS  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 291 Prot.  
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 01 . 03 .2010

**Lënda:** Dërgohet raporti statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për periudhën 1 Janar – 28 Shkurt 2010

**Drejtuar:** **Z. BUJAR NISHANI**  
**MINISTËR I DREJTËSISË**

**TIRANË**

**I nderuar Z. Ministër!**

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", po Ju paraqesim raportin statistikor mbi aktivitetin e Shërbimit të Provës për periudhën 1 Janar – 28 Shkurt 2010.

Duke Ju uruar punë të mbarë!

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**ARBEN SEFGJINI**

Konc. Saimir Shyti  
Date. 01.03.2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
SHËRBIMI I PROVËS

**R A P O R T I**  
**PËR PERIUDHËN 1 JANAR – 28 SHKURT 2010**

**1 Mars 2010**

---

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative", po Ju paraqesim raportin e veprimtarisë së Shërbimit të Provës për periudhën 1 Janar – 28 Shkurt 2010.

## I. Statistika

Për periudhën 1 Janar-28 Shkurt 2010, Shërbimi i Provës ka kryer një volum pune të madh, duke marre parasysh faktin që numri i specialisteve të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës është i njëjti, ndërsa numri i të dënuarve me dënime alternative që këta specialiste mbikëqyrin, si dhe kërkesat nga Gjykata dhe prokuroritë për raporte vlerësimi janë në rritje të vazhdueshme. Disa nga statistikat dhe paraqitjet grafike që pasqyrojnë punën që ka kryer e po kryen institucioni do të jepen me anë të të dhënave si më poshtë:

### *1. Numri total i të dënuarve me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës*

**Numri total i të dënuarve** me dënime alternative që mbikëqyren nga Shërbimi i Provës në të gjithë vendin, në total nga 01.06.2009-28.02.2010 është **1053** të dënuar (vetëm për periudhën 01 janar - 28 Shkurt 2010 është shtuar me 348 të dënuar). Mbikëqyrja për secilin prej tyre realizohet mbi bazën e programeve individuale të trajtimit.

- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Tiranë mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës 566 të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës 157 të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Fier mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës 204 të dënuar me dënime alternative.
- Në territorin që shtrin kompetencat Zyra Vendore Shkodër mbikëqyren në komunitet nga Shërbimi i Provës 126 të dënuar me dënime alternative.


**2. Numri mesatar i të dënuarve me dënime alternative që mbikqyren nga një punonjës i Shërbimit të Provës në nivel vendi dhe zyre vendore.**

Aktualisht është 36 numri mesatar i të dënuarve që mbikqyren nga një punonjës në nivel vendi. E shprehur kjo për çdo zyrë vendore, nga ku del edhe ngarkesa për çdo punonjës të këtyre zyrave, është si më poshtë:

- Zyra Vendore Tiranë ka nën mbikëqyrje 57 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Durrës ka nën mbikëqyrje 26 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Fier ka nën mbikëqyrje 29 të dënuar për çdo punonjës.
- Zyra Vendore Shkodër ka nën mbikëqyrje 21 të dënuar për çdo punonjës.

**Tabela 1, Grafiku 1: Ngarkesen mesatare e punes per Zyrat Vendore.**

Nr	Zyrat Vendore	Të dënuar në mbikëqyrje	Nr. Punonjësve sipas ZVSHP	Të mbikëqyrrur për specialist
1	Zyra Vendore SH	126	6	21
2	Zyra Vendore DR	157	6	26
3	Zyra Vendore FR	204	7	29
4	Zyra Vendore TR	566	10	57
	<b>TOTALI</b>	<b>1053</b>	<b>29</b>	<b>36</b>



### 3. Numri i të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ

Një statistikë tjetër e rëndësishme është ajo që na jep numrin e të dënuarve për secilin lloj dënimi alternativ, si më poshtë:


- 852 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59 i KP *“pezullim i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”*, shifër kjo e barabartë me 80.91% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 15 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 59/a i KP *“qëndrim në shtëpi”*, shifër kjo e barabartë me 1.42% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 78 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 63 i KP *“Pezullim i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik”*, shifër kjo e barabartë me 7.41% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 1 person është dënuar nga gjykata duke aplikuar nenin 58 të KP *“gjysëmliria”*, shifër kjo e barabartë me 0.1% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.
- 107 persona janë dënuar nga gjykata duke u aplikuar neni 64 i KP *“Lirim me kusht”*, shifër kjo e barabartë me 10.16% të të gjithë të dënuarve me dënime alternative.

Sikurse tregojnë shifrat, mbizoteron në masë të madhe aplikimi nga gjykata e nenit 59 të KP *“pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”*, duke bërë të mundur mosdërgimin në burg për vuajtjen e dënimit të autorëve të veprave penale, por kalimin e tyre nën mbikqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën e provës që varion nga 18 muaj deri në 5 vjet.

Në radhë të dytë qëndron numri i të dënuarëve të liruar me kusht në aplikim të nenit 64 të KP *“Lirim me kusht”*. Kjo shifër përbën numrin e të dënuarëve që lënë burgun dhe që vihen nën mbikqyrjen e Shërbimit të Provës për periudhën e provës që cakton gjykata.

Tabela 2, Grafiku 2: Llojet e Denimeve Alternative te dhena nga Gjykatat.

Nr	Lloji i Denimeve Alternative	ZV Durres	ZV Fier	ZV Shkoder	ZV Tirane	Nr. Total i te denuarve	Nr. Total i te denuarve ne %
1	Pezullimi neni 59 i KP	114	179	116	443	852	80.91%
2	Qendrimi ne shtepi neni 59/a i KP	7	4	1	3	15	1.42%
3	Lirimi me kusht neni 64 i KP	17	21	8	61	107	10.16%
4	Pune me interes publik neni 63 i KP	19	0	1	58	78	7.41%
5	Gjysem liria neni 58 i KP	0	0	0	1	1	0.10%
<b>TOTALI</b>		<b>157</b>	<b>204</b>	<b>126</b>	<b>566</b>	<b>1053</b>	<b>100%</b>




**4. ritmi i rritjes së ngarkesës për Shërbimin e Provës, për çdo muaj që nga dita e krijimit të tij.**

Por një statistikë tjetër tregon ritmin e aplikimit të dënimeve alternative që është i njëjtë me ritmin e rritjes së ngarkesës së Shërbimit të Provës.

Tabela 3 TE DENUARIT ME DENIME ALTERNATIVE PER PERIUDHEN 01.01-28.02.2010

Nr	ZYRAT VENDORE	Qershor '09	Korrik '09	Gusht '09	Shtator '09	Tetor '09	Nentor '09	Dhjetor '09	Janar '10	Shkurt '10	TOTALI
1	ZV Tirane	36	55	6	51	41	73	156	99	49	566
2	ZV Durres	0	21	4	6	29	19	23	35	20	157
3	ZV Fier	0	13	1	17	32	34	14	44	49	204
4	ZV Shkoder	0	14	2	8	9	23	18	28	24	126
TOTALI		36	103	13	82	111	149	211	206	142	1053

Grafiku 3



5. *periudha e provës në të cilën janë në mbykqyrje të dënuarit me dënim alternativ që mbikqyren deri tani nga Shërbimi i Provës si dhe numri i të dënuarve për secilën periudhë prove*


Në më të shumtën e rasteve gjykata ka vendosur si periudhë prove periudhën nga 18 muaj deri në 2 vjet e cila përbën 73,47% të rasteve. Tabela dhe grafiku më

poshte japin një pasqyrë të plotë të gjatësisë së periudhës së provës dhe numrin e të dënuarve për secilën periudhë të shprehur edhe në përqindje në raport me numrin total të dënimeve të dhëna me periudhë prove. Në 20 raste Gjykata ka dhënë dënime për periudhë prove me të vogël se 18 muaj.

Tabela 4

Nr	LËNDA	PERIUDHA E PROVËS							
		<18muaj	18 muaj	2 vjet	2 vjet 6 muaj	3 vjet	4 vjet	5 vjet	18 muaj - 5 vjet
1	Periudha e provës								
2	Nr të dënuarve	20	381	336	7	156	24	52	976
3	% e të dënuarve	2,05%	39,04%	34,43%	0,71%	15,98%	2,46%	5,33%	100%

Grafiku 4




**6. Numri i të dënuarve me "punë me interes publik" sipas zyrave vendore dhe sipas numrit të orëve të punës të dhëna nga gjykata**

Numri i të dënuarve me "punë në interes publik" në të gjithë vendin është 78 prej të cilëve 58 janë në territorin ku shtrin kompetencat zyra vendore e Tiranës dhe 19 në territorin ku shtrin kompetencat Zyra Vendore Durrës. Tabela më poshtë na jep pasqyrën e plotë për këtë statistikë:



Tabela 5, Grafiku 5

Nr	Zyra Vendore	Numri i të dënuarve	Orë pune
1	Zyra vendore TR	40	40
		3	50
		9	60
		1	70
		4	80
		1	120
2	Zyra vendore DR	9	40
		1	50
		3	60
		3	80
		1	100
		2	120
3	Zyra Vendore FR	0	0
4	Zyra Vendore SH	1	40
<b>TOTALI</b>		<b>78</b>	



Veç sa më sipër, renditjeve në këtë kapitull të statistikave, ka edhe tregues të tjerë që përcaktojnë volumin e madh të punës e ngarkesës për punonjësin e Shërbimit të Provës në realizimin e detyrave të tij funksionale.

Një tregues tjetër i punës që bëjnë punonjësit e Shërbimit të Provës është edhe përgatitja e Raporteve të Vlerësimit me kërkesë të gjykatës dhe prokurorisë.

Konkretisht për periudhën 9 mujore:

- ❖ janë kërkuar nga gjykata 599 raporte vlerësimi per persona te pandehur dhe te denuar,
- ❖ janë kërkuar nga prokurorite 107 raporte vlerësimi per persona nen hetim dhe te pandehur,
- ❖ kanë ardhur 1053 urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nga të cilët 128 urdhëra ekzekutimi janë për dënime alternative të dhëna për të mitur, për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative dhe kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikqyrjes për ta.

## II. Problem i Hapjes se Zyrave Vendore te reja.

Sikurse Ju kemi bërë me dije, në Raportin për aktivitetin e Shërbimit të Provës, dërguar me tonën Nr. 365 Prot., datë 06.10.2009, problemi themelor i Shërbimit të Provës është hapja e zyrave të reja vendore me vendodhje te pakten në rrethet gjyqësore Lezhë, Korçë, Elbasan, Gjirokastër me qëllim administrimin dhe ushtrimin e funksioneve në mënyrën e kërkuar nga ligji.

Shërbimit të Provës po ushtron funksionet e tij me një staf që po punon me kërkesa të larta, por vështirësitë janë në rritje. Punonjësit e Zyrave Vendore realizojnë takime në të gjitha burgjet e vendit. Mjafton të përmendim se deri tani janë në mbikqyrje nga institucioni ynë 1053 të dënuar, ose mesatarisht **36 të dënuar për çdo specialist**, numër i cili vazhdon të rritet. Kjo shifer ne krahasim me standartet e vendeve europiane, ku numri mesatar i te denuarve per specialist eshte rreth 30-35 persona, eshte me e larte po te mbajme parasysh se punonjesit tane bejne edhe mesatarisht **24 raporte vleresimi per specialist**, sipas kerkesave te gjykatave dhe prokurorive.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë të të dhënave statistikore që pasqyrojnë me objektivitet punën e kryer-si dhe një paraqitje të problematikes themelore nga Shërbimi i Proves, Ju sigurojmë se zbatimi i të gjithë detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë edhe në të ardhmen.

Me respekt,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**ARBEN SEFGJINI**

